



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.06.2019, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Shqyrtimi i kërkesës për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës.
2. Miratimi i kalendarit të komisionit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës.
3. Caktimi i relatorëve për shqyrtimin e kërkesës.
4. Prezantimi i kërkesës nga nismëtarët.
5. Pyetje drejtuar nismëtarëve.

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Andi Përmeti, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braha dhe Ralf Gjoni.

#### **Mungojnë:**

Alket Hyseni, Damian Gjikhuri, Edmond Leka, Alban Zeneli, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Taulant Balla – Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste  
Ervin Bushati – Sekretar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme, meqenëse kuorumi është i plotësuar për të vazhduar me çështjen që kemi sot në rendin e ditës.

Siç edhe jeni në dijeni, unë kam njoftuar në mbledhjen e djeshme kolegët e Komisioni të Ligjeve në lidhje me depozitimin e kërkesës për shkarkimin e Presidentit të Republikës, kërkesë e një grupi prej 55 deputetësh, bazuar në nenin 90/2 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenin 112 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Fillojmë sot shqyrtimin e kërkesës për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës. Në rendin e ditës kemi përcaktuar miratimin e një kalendari të komisionit për shqyrtimin e kërkesës së këtij grupi deputetësh për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës. Do të caktojmë, në vlerësimin tim, dy relatorë në lidhje me këtë kërkesë, pastaj do t'ua kalojmë fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar, zotit Balla, dhe sekretarit të grupit, zotit Bushati, të cilët kanë ardhur të prezantojnë kërkesën në emër të grupit të deputetëve firmëtarë. Më tutje do të vazhdojmë me pyetje nga kolegët, nëse do të kenë pyetje për nismëtarët. Por, gjithsesi, unë mendoj të fillojmë me pikën e parë.

Kolegët deputetë e kanë përpara draftkalendarin për shqyrtimin e kërkesës për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës.

Siç e dini, bazuar në pikën 2 të nenit 112 të Rregullores, kërkesa i është njoftuar Presidentit të Republikës dhe Komisionit të Ligjeve nga Kryetari i Kuvendit. Komisioni i Ligjeve brenda 15 ditëve, nga dita e marrjes së kërkesës, do të hartojë një raport për seancën plenare, në përfundim të të cilit do t'i kërkojë seancës plenare menjëherë ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për të hetuar nëse në veprimtarinë e Presidentit të Republikës është shkelur neni 90/2 i Kushtetutës.

Përsëri në bazë të Rregullores, në rast se Presidenti kërkon të dëgjohet në Komisionin e Ligjeve, ky i fundit i krijon mundësitë Presidentit të vijë të shprehet pranë këtij komisioni, por, gjithsesi, kjo është çështje që i përket mbledhjes së radhës, sipas kalendarit që ne do të miratojmë.

Biem dakord me draftkalendarin?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Adriatik Alimadhi**– Ju lutem, se këtu thuhet: “nisma prej 55 deputetësh”, por listën nuk e kemi të bashkëngjitur.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

I është bashkëngjitur kërkesës, madje janë edhe firmëtarët.

**Adriatik Alimadhi** – Kërkoj ndjesë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Po, zoti Gjoni.

**Ralf Gjoni** – Faleminderit!

Nëse mundem, kam nja dy komente lidhur me procedurën e ndjekur.

Të nderuar kolegë, nuk e di nëse ju keni shkarkuar ndonjëherë ndonjë president. Me sa po shoh këtu, duket sikur ju po trajtoni një nismë të thjeshtë ligjore, ndërkohë që bëhet fjalë për shkarkimin e Presidentit të Republikës.

Dua t'i thërras zërit të arsyes suaj njerëzore, përpara se të mendoni me arsyen politike: vendi po shkon drejt një kaosi të panevojshëm dhe jam shumë i shqetësuar që, brenda një harku kohor prej shtatë ditësh, nuk hapen negociatat me BE-në; Presidenti ndryshon datën e zgjedhjeve ose anulon dekretin; parlamenti i bën karshillëk, duke filluar procedurat për shkarkimin e tij; digjen qendra elektorale (shkolla). Pra, fillojnë shenjat e para...

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Gjoni!

**Ralf Gjoni** – Ju lutem, ta mbaroj fjalën!

**Ulsi Manja** – Nuk është për procedurë kjo!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

**Ralf Gjoni** – Një sekondë, se do të dal aty!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, më lini ta mbaroj!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Gjoni, se kjo nuk është për procedurë!

**Ralf Gjoni** – Për procedurë e kam.

Të nderuar kolegë, në kontekstin aktual që po kalon Shqipëria, më duket i nxituar propozimi i një kalendari kaq të shpejtë. Bëhet fjalë që të mërkurën, pra sot, miratimi...

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Prisni, zoti Fino, ju lutem, se...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mirë, e mbytet opozitën e kaluar, por na lini të shprehemi, ju lutem!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Gjoni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ralf Gjoni** – Më lini ta mbaroj!

E kam lexuar siç duhet!

Pra, bëhet fjalë që të mërkurën, pra sot, kemi miratimin e kalendarit për shqyrtimin e kërkesës, caktimin e relatorëve, prezantimin e kërkesës nga nismëtarët dhe në fund pyetje drejtuar nismëtarëve. Pastaj të hënën, pra brenda një jave, vazhdojmë me procedurën e shkarkimit, ndërsa të mërkurën, datë 26.06.2019, brenda qershorit, ju doni të përmbyllni procedurën e shqyrtimit, votimin e propozimit, përgatitjen dhe përcjelljen e raportit në seancë plenare.

Sugjeroj...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, ta mbaroj!

Sugjeroj që afatet kohore për shqyrtimin e kërkesës në seancë plenare, edhe për shkak të krizës aktuale që po kalon Shqipëria, madje edhe në interes të axhendës europiane të Shqipërisë, të shtyhen pas zgjedhjeve të 30 qershorit.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Gjoni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, zoti Fino!

Unë jam i detyruar të respektoj në mënyrë strikte nenin 112 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, i cili në pikën 2 thotë: “Komisioni i Ligjeve, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës, i paraqet seancës plenare raportin për ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar për të hetuar nëse në veprimtarinë e Presidentit të Republikës, që ka anuluar me një akt juridik...

*(Deputeti Gjoni flet pa mikrofon.)*

Ju lutem, zoti Gjoni!

**Ralf Gjoni** – Ndoshta nuk u kuptova.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, mos më ndërprisni!

**Ralf Gjoni** – Ndoshta nuk isha i qartë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, mos ndërhyjni!

Pra, nëse në veprimtarinë e Presidentit të Republikës ka ose jo shkelje të nenit 90/2 të Kushtetutës.

Kemi një rend të përcaktuar, kemi një afat kohor që e ka disiplinuar Rregullorja e Kuvendit, ndaj, të nderuar kolegë, dua të hedh në votim draftkalendarin që keni mbi tavolinë.

Biem dakord me draftkalendarin? Kush është pro?

Atëherë, miratohet draftkalendarin për shqyrtimin e kërkesës së disa deputetëve për fillimin e procedurës së shkarkimit të Presidentit të Republikës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe një herë, kush ishte pro draftkalendarit? Kundër? Tri vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet draftkalendarin.

Atëherë, fillojmë sot me prezantimin e kërkesës nga nismëtarët.

Po ia kaloj fjalën zotit Balla, si kryetar i grupit parlamentar dhe si njëri nga firmëtarët e kërkesës për shkarkimin e Presidentit, për të bërë një prezantim të kërkesës për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Më pas do të procedojmë me pyetje dhe caktimin e relatorëve.

**Taulant Balla** – I nderuar zoti kryetar,

Zonja dhe zotërinj anëtarë të këtij komisioni të nderuar,

Më lejoni, së pari, që në emër të 55 firmëtarëve, siç parashikojnë Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit, të prezantoj një kërkesë që përbën më shumë se një të katërtën e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë.

Kërkesa jonë bazohet në një procedurë, e cila parashikon që, pas depozitimit të saj në Kuvendin e Shqipërisë, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë e ka njoftuar seancën plenare.

Pa dashur të bëj aspak replikë me një nga deputetët parafolës, askush nuk mund të shkelë Rregulloren, sepse nga dita e depozitimit të kërkesës në Kuvend janë 15 ditë në dispozicion të Komisionit të Ligjeve që të japë vlerësimin.

Po kaloj tani te rrethanat, të cilat kanë bindur firmëtarët për të paraqitur këtë kërkesë, dhe rrethanat mbi të cilat bazohet kërkesa.

Presidenti i Republikës, në ushtrim të kompetencës së dhënë nga Kushtetuta, që parashikohet në germën “gj” të nenit 92 të saj, ka nxjerrë dekretin nr. 10928, datë 05.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”. Në bazë të këtij dekreti, është caktuar si datë e mbajtjes së zgjedhjeve data 30 qershor 2019.

Në përmbushje të këtij parashikimi kanë filluar dhe janë drejt përfundimit të gjitha procedurat sipas Kodit Zgjedhor për bërjen të mundur brenda afateve kushtetuese dhe ligjore të procesit zgjedhor. Konkretisht, në momentin që flasim, janë ngritur komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, të parashikuara sipas nenit 28 të Kodit Zgjedhor në Republikën e

Shqipërisë; janë përgatitur dhe janë shpallur listat e zgjedhësve, sipas nenit 56; është kryer regjistrimi i partive politike, mbi 35 parti politike; janë depozituar listat e kandidatëve të partive politike; janë regjistruar kandidatët e partive politike, sipas nenit 67; ka filluar fushata zgjedhore dhe hapa të tjerë që çojnë drejt përfundimit të këtij procesi, ndërkohë që jemi në vijim të periudhës zgjedhore dhe Presidenti nxjerr në mënyrë krejt të papritur, dekretin nr. 11 199, datë 10.06.2019 për shfuqizimin e dekretit nr. 10928, datë 05.11.2018 po të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”. Sipas nenit 1 të këtij dekreti shfuqizohet dekreti nr. 10928, datë 05.11.2018 i Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, duke anuluar datën 30 qershor 2019, si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.

Arsyet e dhëna nga Presidenti i keni në kërkesë dhe nuk po ju marr kohën tuaj të vlefshme për t’i ricituar.

Ne kërkuesit, duke vlerësuar se me anulimin e datës së zgjedhjeve Presidenti ka kryer një shkelje të rëndë të Kushtetutës, kemi paraqitur këtë kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës, bazuar në nenin 90, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 112 të Rregullores së Kuvendit për aspektin procedural, me arsyetimin që po e përmbledh, si më poshtë. Dekreti nr. 11199/2019 vjen në kundërshtim të hapur me parimet kushtetuese të një republike të pastër parlamentare, të funksioneve të Presidentit të Republikës të parashikuara nga Kushtetuta dhe nga parimet e funksionimit të normal të sovranitetit të popullit shqiptar. Është cenuar rëndë parimi i ushtrimit të sovranitetit nga populli. Ky është konstatimi ynë i parë si kërkues në këtë kërkesë.

Kushtetuta në nenin 2, paragrafi i parë parashikon se sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. Këtë sovranitet populli e ushtron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet të zgjedhurve të tij.

Me dekretin nr. 11199/2019 Presidenti ka anuluar datën 30 qershor 2019, si datë të mbajtjes së zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor. Në këtë kuptim, Presidenti i ka hequr sovranitetin të drejtën për të qenë i tillë.

Ushtrimi i kompetencës sovrane të popullit për të zgjedhur, është shprehje e vullnetit të tij për sigurimin e vazhdimësisë së pushtetit apo delegim për një administrim më të mirë të pushtetit.

Nga ana tjetër, është edhe ushtrim i drejtpërdrejtë i pushtetit sovran duke kontrolluar çdo 4 vjet të zgjedhurit e vet. Anulimi dhe moscaktimi i një date të re për mbajtjen e zgjedhjeve,

është një hap që zhbën në vetvete autoritetin sovran që i heq atij të drejtën për të qenë i tillë. Anulimi i datës 30 qershor si datë e mbajtjes së zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor, nëpërmjet një akti administrativ dhe, më rëndë akoma, mosaktimi i një date tjetër për mbajtjen e tyre, i mohon në thelb të drejtën e sovranit për të qenë i tillë.

Së dyti, Presidenti me këtë dekret u ka zgjatur mandatin njësisive të qeverisjes vendore. Pavarësisht se nga pikëpamja formale akti nuk është ligj dhe nuk disponon mbi mandatin dhe kohën e qëndrimit në detyrë të përfaqësuesve të zgjedhur të njësisive të qeverisjes vendore, praktikisht, duke anuluar datën e zgjedhjeve Presidenti i lë në detyrë këto organe tej mandateve të njohura nga Kushtetuta dhe nga ligji. Kjo praktikë vjen në kundërshtim me parimin kushtetues të periodicitetit të zgjedhjeve. Ju lutem, referojuni pikave 16, 17 dhe 18! Praktikisht, zgjat mandatin e organeve të zgjedhjeve.

Këtë atribut e ka vetëm sovranit. Ai e ka përcaktuar atë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë, kjo është një kompetencë e ligjvënësit në bërjen e ligjeve. E gjithë korniza ligjore, Kushtetuta dhe ligjet e tjera të miratuara nga Kuvendi përcaktojnë se mandati i të zgjedhurve qoftë të qeverisjes qendrore, qoftë i atyre të njësisive të qeverisjes vendore është vetëm 4-vjeçar.

Me dekretin nr. 11199/2019, zgjatet qëndrimi në detyrë i të zgjedhurve vendorë tej mandatit të tyre. Ky është një disponim që vjen në kundërshtim me kornizën kushtetuese dhe ligjore. Ne vlerësojmë se me këtë dekret Presidenti i ka njohur vetes atributet e ligjvënësit, madje edhe të sovranit, ç'ka vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me Kushtetutën.

Presidenti ka përcaktuar (siç duket deri tani), një datë zgjedhjesh tej datës së përcaktuar me ligj. Periodiciteti i zgjedhjeve është përcaktuar qartë në nenin 1/3 të Kushtetutës dhe është detajuar nga ana procedurale në parashikimet e Kodit Zgjedhor. Pra, ne kur miratojmë Kodin Zgjedhor ose kur e ndryshojmë atë, i referohemi pikërisht këtij parimi kushtetues, që është në nenin 1 të Kushtetutës. Presidenti në këtë rast ka vendosur një datë zgjedhjesh për organet e pushtetit vendor, tej atyre të njohura nga ligji. Kodi Zgjedhor në nenin 8 njeh si periudha zgjedhore datat: 15 mars deri në 30 qershor dhe 15 shtator deri në 30 tetor. Ndërkohë, caktimi i datës së zgjedhjeve është i lidhur me mbarimin e mandatit të të zgjedhurve aktualë.

Në këtë rast, në këtë kasus që keni përpara, Presidenti ka marrë atributet e Kuvendit dhe të sovranit, sepse duke “anuluar” datën 30 qershor 2019 si datë të mbajtjes së zgjedhjeve, duhet të caktojë një datë të re. Në çdo rast, një datë e re do të jetë përtej hapësirës kohore të caktuar nga Kushtetuta dhe nga Kodi Zgjedhor mbi kohën e mbajtjes së zgjedhjeve vendore. Edhe në rast se do të ishim në kushtet e zgjatjes së mandatit të organeve të njësisive të qeverisjes

vendore, ajo gjithsesi duhej të bëhej vetëm me dy mekanizma: ndërhyrje në ligj apo ndërhyrje në Kushtetutë. Autoriteti i vetëm për të bërë të tilla ndërhyrje është vetëm trupa legjislative dhe në këtë rast Presidenti ka marrë atributet e ligjvënësit (të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë) me caktimin e një date zgjedhesh tej afateve të njohura nga ligji.

Në arsyetimin e aktit të tij, Presidenti shprehet se kjo situatë ka precedentë të mëparshëm dhe referon për këtë situatën e vitit 2007.

Dëshiroj të ritheksoj se situata e vitit 2007 është pikërisht e kundërta e këtij rasti. Kështu, në situatën e vitit 2007 ka qenë caktuar si datë e mbajtjes së zgjedhjeve data 20 janar 2007. Pas konfliktit politik, më 12 janar është arritur një marrëveshje politike mes palëve, ku pjesë e konsensusit ishte edhe ndryshimi i Kodit Zgjedhor për afatet zgjedhore. Ky kod u ndryshua me ligjin nr. 9676, datë 13.01.2017. Pjesë e ndryshimeve ishin pikërisht, edhe parashikimet krejt të posaçme për caktimin e datës së ardhshme të zgjedhjeve. Kështu, në nenin 38 të ligjit ndryshues parashikohej: “1. Për zgjedhjet vendore të vitit 2007 Presidenti i Republikës, pavarësisht nga përcaktimet e bëra në nenin 7, pika 8 të këtij Kodi, në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ricakton datën e zhvillimit të zgjedhjeve, jo më vonë se data 20 shkurt 2007.”

Me miratimin e këtij akti, dhe vetëm pas miratimit të këtij akti, Presidenti i Republikës në atë kohë, Shkëlqesia e tij, zoti Alfred Moisiu, nxori dekretin nr. 5194, datë 14.01.2007, i cili përcaktonte si datë të zgjedhjeve vendore datën 18 shkurt 2007 (brenda afatit të 20 shkurtit, që i vuri Kuvendi me ligj). Sa më sipër, kjo ka qenë një situatë e posaçme, rregulluar me ligj të posaçëm nga Kuvendi dhe nuk ka fare ngjashmëri me situatën aktuale.

Vazhdoj me argumentin që vijon. Presidenti ka dekretuar anulimin e zgjedhjeve, ndërkohë që Kushtetuta nuk ia njej aspak këtë të drejtë. Kushtetuta në nenin 92, germa “gj” i njej Presidentit të drejtën e caktimit të datës së zgjedhjeve. Siç shpjegohet edhe më poshtë, kjo është një kompetencë vetëm njëkahëshe nga ana e Presidentit. Sipas Kushtetutës ai ka funksion dhe detyrë, të caktojë datën e zgjedhjeve dhe nuk ka asnjë alternativë tjetër për të shfuqizuar, ndryshuar, apo aq më tepër (qoftë larg), anuluar datën e zgjedhjeve. Nëse do të pranojmë se anulimi i datës së zgjedhjeve, është kompetencë që shkon edhe me caktimin e asaj date, praktikisht do të pranohet një president me tagra pushteti mbi legjislative, mbi ekzekutive, që referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ky President, qoftë Ilir Meta, qoftë kushdo tjetër, nuk i ka. Është cenuar parimi i periodicitetit të zgjedhjeve dhe, sikur citova më lart, është një prej parimeve më të rëndësishme, mbi të cilën është organizuar funksionimi dhe ndarja e pushteteve në Republikën e Shqipërisë.



Gjithashtu, dua të vlerësoj se me dekretin nr. 11 199/2019 Presidenti ka cenuar rëndë parimin e periodicitetit. Kushtetuta në nenin 1, pika 3, parashikon se qeverisja parashikohet në një sistem zgjedhjesh të lira të barabarta, por të përgjithshme dhe periodike. Periodiciteti i zgjedhjeve është i përcaktuar prapë në Kushtetutë, respektivisht në nenet 65 dhe 109, ku parashikohet praktikisht se zgjedhjet për organet e pushtetit vendor dhe zgjedhjet e përgjithshme parlamentare do të zhvillohen çdo 4 vjet. Ky është pikërisht koncepti i periodicitetit që kushtetutbërësi ka. Nëse do të zbatohet dekreti nr. 11 199/2019 automatikisht kemi të bëjmë me parimin se të zgjedhurit do të rrinin në detyrë përtej një mandati të përcaktuar qartë në Kushtetutë, që do të thotë se çdo veprimtari e kryer jashtë afatit është antikushtetuese. Periodiciteti i zgjedhjeve është parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Kodin Zgjedhor si dokument pasues poshtë Kushtetutës, si një moment rotativ me kohë të përcaktuar qartë një herë në katër vjet. Në këtë kuptim, dalja përtej këtyre afateve do të cenonte parimin kushtetues dhe ligjor të periodicitetit të zgjedhjeve.

Së gjashti, është cenuar parimi i një qeverisjeje të dalë nga zgjedhje të lira, themel i demokracisë. Kushtetuta që në nenin e parë, pasi parashikon formën e sistemit tonë politik, atë të një republike të pastër parlamentare, formën unitare dhe të pandashme të shtetit, përcakton se administrimi, procesi qeverisës duhet të zbatohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe juridike. Nëse i kalojmë këto parashikime lidhur me periodicitetin, do të kemi praktikisht një shtet dhe një shoqëri që nuk qeveris. Sikur edhe një ditë më shumë, 24 orë, të rrinë në detyrë të zgjedhurit, ata humbasin konceptin e qeverisësit dhe të administratorit, automatikisht kthehen në pushtete pa mandat, ose, thënë ndryshe, pse jo, pushtete autoritare. Dalja përtej afateve kushtetuese bën që zgjedhjet të mos jenë më të tilla dhe, për rrjedhojë, të mos i lidhë asnjë mandat me administrimin e pushtetit të dhënë për t'u administruar. Që në këtë moment ata kthehen në ushtrues pa tagra të këtij pushteti dhe vazhdojnë të ushtrojnë pushtet duke mos u ndjerë të lidhur fare me kontrollin nga sovrani. Në këtë kuptim, dekreti i Presidentit përbën një cenim të rëndë të Kushtetutës, sepse cenon në themel rendin kushtetues në demokracinë tonë të re dhe në Republikën e Shqipërisë, duke bërë të pamundur edhe qeverisjen e vendit sipas koncepteve të rëna dakord në ligjin bazë themelor të vendit.

Së shtati, është cenuar rëndë parimi i kushtetutshmërisë. Kushtetuta në nenin 4 parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë dhe se e drejta përbën bazën e ndërtimit të shtetit. Deklarimi e epërsisë së Kushtetutës, duke e vendosur në majë të piramidës juridike, përbën një aspekt thelbësor të parimit të shtetit të së drejtës. Ky parim i

detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe në atë material. Me veprimin e tij administrativ Presidenti i Republikës ka cenuar rëndë parimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë. Presidenti me dekretin nr. 11 199/2019, që praktikisht sipas tij anulon mbajtjen e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, cenon parimin e periodicitetit dhe ushtrimin e të drejtës sovrane të popullit për të zgjedhur. Në këto kushte ai ka cenuar rëndë Kushtetutën, si akti më i lartë në Republikën e Shqipërisë. Këto janë detyrime kushtetuese, të cilat nuk mund të tejkalohen as me ligj dhe, aq më tepër, me një dekret presidencial. Dispozita kushtetuese mbi ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë janë mishërim i parimit të shtetit të së drejtës, që nënkupton se çdo vendimmarrje duhet t'i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurojmë ekzistencën e një shteti të drejtë dhe funksional.

Së teti, është shkelur parimi i ligjshmërisë. Të gjitha organet publike në vend, madje edhe Presidenti i Republikës, duhet ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm të mbështetur në ligj, dëshirat nuk mund të jenë pjesë e orientimit të çdo funksionari në Republikën e Shqipërisë. Këto i parashikon neni 4 i Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet se të gjitha organet publike duhet të ushtrojnë veprimtaritë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë brenda kufijve dhe kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Akti i Presidentit vjen në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 92, germa "gj", të Kushtetutës dhe parashikimeve konkrete që rregullojnë afatet dhe mënyrën e caktimit nga Kodi Zgjedhor, ndërkohë që Kushtetuta i njeh Presidentit vetëm të drejtën e caktimit të datës së zgjedhjeve. Kodi Zgjedhor normon veprimtarinë e Presidentit për kohën, hapat proceduralë dhe kur duhet të veprojë për caktimin e datës së zgjedhjeve.

Së nënti, akti i Presidentit ka dalë në kundërshtim të hapur flagrant me kompetencën që i ka dhënë Kushtetuta sovranit. Presidenti, referuar parashikimeve kushtetuese në lidhje me zgjedhjet, ka vetëm një kompetencë, atë të dekretimit të datës së zgjedhjeve, prej së cilës ndërvaren një seri vendimmarrjesh të KQZ-së, siç ju informova më lart, të kryera deri tani. Kjo e fundit sapo merr dijëni për dekretin e datës së zgjedhjeve fillon veprimtarinë për organizimin dhe menaxhimin e procesit zgjedhor. Kjo kompetencë ushtrohet nga Presidenti vetëm një herë për çdo zgjedhje, sipas parashikimeve kushtetuese dhe legjislacionit në fuqi për zgjedhjet, neni

92, germa “gj”, neni 94 të Kushtetutës dhe nenet 8, 9, 10 të Kodit Zgjedhor. Ndryshimi i datës së zgjedhjeve administrative nuk është një prerogativë e Presidentit, e parashikuar në Kushtetutë ose në Kod Zgjedhor. Sipas neni 94 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre të njohura shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligj. Akti që del në mungesë të kompetencës është nul dhe konsiderohet se nuk ka ekzistuar asnjëherë. Ligji i posaçëm i Kodit Zgjedhor nuk i ka njohur më asnjë të drejtë Presidentit për të ndërhyrë në këtë proces, për të përcaktuar një datë të re zgjedhjesh, aq më tepër për të lënë vendin pa zgjedhje. Me caktimin e kësaj date, procesi i zgjedhjeve starton dhe, në këtë kuptim, Presidenti i Republikës e ka të pamundur të influencojë në vijueshmërinë e procesit. Caktimi i datës së zgjedhjeve është momenti i parë, por edhe i fundit që Presidenti përfshihet në këtë proces. Në vlerësim sa më sipër, akti i nxjerrë nga Presidenti ka dalë në kundërshtim me kompetencën e Presidentit dhe është një akt që cenon rëndë parimin e ligjshmërisë.

Së dhjeti, mbi natyrën e kompetencës për caktimin e datës së zgjedhjeve, dekreti nr. 11 199 i vitit 2019 cenon rëndë parimin e ligjshmërisë, sepse është një akt, i cili nuk i njihet Presidentit në asnjë dokument të natyrës kushtetuese, ligjore apo edhe të një praktike të mirë kushtetuese, zakon kushtetues nëse doni.

Referuar neni 92, germa “gj”, të Kushtetutës, se Presidenti ushtron kompetencën e caktimit të datës së zgjedhjeve, përndryshe Presidenti ka për kompetencë vetëm të caktojë datën e zgjedhjeve nëpërmjet aktit të dekretit. Kjo kompetencë është vetëm e njëkahshme për të bërë një paralele me funksione legislative apo ekzekutive, ku të dyja organet, parlamenti dhe Këshilli i Ministrave mund të miratojnë, shfuqizojnë apo ndryshojnë aktet e tyre, funksioni i Presidentit në këtë rast është me natyrë më të kufizuar. Ai cakton vetëm një datë për mbajtjen e zgjedhjeve dhe nuk ka hapësirë për ta ndryshuar atë, për më tepër, Presidenti nuk ka kompetencë të mos caktojë datën e zgjedhjeve, siç ka bërë me dekretin nr. 11 199 të vitit 2019.

Së njëmbëdhjeti, akti i Presidentit cenon mundësinë për të zgjedhur, që u bëhet qytetarëve. Neni 45 i Kushtetutës parashikon se çdo qytetar që ka mbushur moshën 18-vjeç ka të drejtë të zgjedhë, por edhe të zgjidhet. Kjo e drejtë bën pjesë në kapitullin e të drejtave dhe lirive politike dhe është pikërisht materializimi i parimit të sovranitetit, që i përket vetëm popullit dhe ushtrimi i tij bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij, siç ne kemi nderin të jemi në këtë sallë. Nëse do të ndjekim linjën e argumentit të Presidentit, dekreti nr. 11 199 i vitit 2019 praktikisht u heq shtetasve, qytetarëve, pra sovranit, të drejtën për të zgjedhur dhe për të prodhuar pushtetin që ata duan. E drejta për të zgjedhur lirshëm është një e drejtë bazë e funksionimit të një shoqërie të lirë. Privimi nga kjo e drejtë është një

cenim shumë i rëndë i parimeve të shtetit të së drejtës dhe të demokracisë. Nuk mund të kuptohet një shtet demokratik nëse nuk zhvillohen zgjedhje dhe nuk u jep të drejtë shtetasve të tij për të ushtruar të drejtën për të zgjedhur. E drejta për të zgjedhur është pika e parë e nisjes së ndërtimit të një pushteti të dalë nga vota e drejtpërdrejtë e popullit dhe baza për ndërtimin e një shoqërie të lirë. Dekreti nr. 11 199 i vitit 2019 cenon rëndë këtë proces, që si pasojë e drejtpërdrejtë ka heqjen e së drejtës për të zgjedhur, ndërkohë pasoja më e rëndë është heqja e pushtetit popullit sovran.

Zonja dhe zotërinj, anëtarë të këtij komisioni të nderuar, nisur nga veprimet e Presidentit të Republikës, natyra e aktit nxjerrë prej tij dhe nga pasoja që ai sjellë, duke cenuar rëndë parimin e ushtrimit të sovranitetit nga ana e popullit, duke shkelur Kushtetutën dhe duke marrë, njëkohësisht, tagra të sovranit dhe të Kuvendit, duke u sjellë arbitrarisht me pushtetin, si pushtet ekzekutiv i pakufizuar, përkundër natyrës së republikës sonë parlamentare, duke shtyrë arbitrarisht datën e zgjedhjeve, duke cenuar parimin e periodicitetit të zgjedhjeve, duke cenuar parimin e ushtrimit të pushtetit në një shtet nga një qeverisje e dalë nga zgjedhje veçse të lira, duke cenuar parimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, duke nxjerrë akte në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjet dhe Kushtetutën, duke cenuar parimin e të drejtës së qytetarëve si sovranë për të zgjedhur, por edhe për t'u zgjedhur, vlerësojmë se këto përbëjnë shkelje shumë të rënda të Kushtetutës dhe ligjeve, të kryera nga Presidenti aktual i Republikës. Në këtë mënyrë plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 90, pika 2, i Kushtetutës, ndaj, përfundimisht, bazuar tërësisht në Kushtetutë, kërkojmë nisjen e procedurave për shkarkimin e Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Balla, për prezantimin shterues të kësaj kërkesë!

Të nderuar kolegë, do t'i rrimë strikt kalendarit që miratua, vetëm pyetje, kurse seanca e diskutimeve dhe debatit në lidhje me kërkesën do të zhvillohet gjerësisht në mbledhjen e radhës!

Zoti Gjoni e ka kërkuar fjalën për pyetje dhe më pas zoti Lita!

**Ralf Gjoni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Balla, ju falënderoj për parashtrimin e kërkesës suaj dhe argumentimin e kërkesës për nisjen e procedurave për shkarkimin e Presidentit. Në një nga pikat tuaja thoni: “Anulimi dhe moskaktimi i një date të re për mbajtjen e zgjedhjeve është një hap që zhbën në vetvete autoritetin sovran, nëpërmjet një akti administrativ, i heq atij të drejtën për të qenë i tillë”. E përsëris akti administrativ. Në dijeninë time, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka injoruar me

të drejtën aktin administrativ të Presidentit të Republikës për anulimin zgjedhjeve. Jemi të gjithë dakord që akti i Presidentit është i paprecedent dhe i panevojshëm dhe ndez situatën politike; këtu politikisht jemi dakord. Por KQZ-ja e ka cilësuar aktin e Presidentit si të pavlefshëm, pra e ka injoruar dhe nuk i është bindur një akti të pavlefshëm administrativ. Ndërkohë, kemi një precedent, dhe ju e dini mirë se sa i rëndësishëm është precedenti në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës Kushtetuese të qershorit të vitit 2017 për shfuqizimin e dekretit të Presidentit Nishani për shtyrjen e zgjedhjeve, kërkesë nga një subjekt politik, që u refuzua për trajtim nga kjo Gjykatë Kushtetuese. Akti i Presidentit, tha Gjykata Kushtetuese, për të shfuqizuar datën e zgjedhjeve nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës e Kushtetuese, por është pjesë e juridiksionit të gjykatave administrative, pra vendimi 16 qershor të vitit 2017.

Kam një pyetje për ju: nis Presidenti ka kryer një akt administrativ të pavlefshëm, të cilin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka injoruar, nëse ne kemi një precedent të dokumentuar të Gjykatës Kushtetuese, që ky akt administrativ i Presidentit mund të sfidohet ligjërisht në Gjykatën Administrative, pse ju e keni kaq të nevojshme të nxitoheni dhe të përshpejtoni nisjen e procedurave për shkelje kushtetuese, ndërkohë që ne nuk kemi ende një Gjykatë Kushtetuese funksionale dhe e dini shumë mirë që shanset janë që, edhe po të ishte konstituuar Gjykata Kushtetuese, duke u nisur nga precedenti i vitit 2017, mund ta trajtojë këtë akt të Presidentit si akt administrativ dhe ta referojë për Gjykatën Kushtetuese?

Është thjesht një pyetje: pse ju po i futeni një korridori kushtetues për Gjykatën Kushtetuese, ndërkohë që ka një precedent si akt administrativ?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Gjoni!

T’i marrim pyetjet me radhë.

Urdhëroni zoti Lita!

**Korab Lita** – Faleminderit, zoti kryetar!

Parimisht, besoj se jemi të gjithë dakord që kjo është një situatë e krijuar nga klasa jonë politike, duke filluar që nga rrënimi total i institucioneve dhe deri te kriza aktuale në të cilën ndodhemi. Për të kaluar këtë krizë apo për t’u justifikuar, kjo klasë politike po mundohet të përdorë qytetarët, rasti është shumë flagrant. Qytetarët meritojnë zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe nuk presin këtë që po u bëhet.

Të dyja kampet kanë hyrë në llogoret e tyre: njëra palë thotë bëjmë zgjedhje pa konkurrim, kurse pala tjetër thotë se nuk do të lejojë të bëhen zgjedhje. Presidenti në

argumentimin e tij ka përcaktuar shqetësimin për situatën e krijuar në vend dhe nevojën e shtensionimit të saj. Mendimi im personal është se dekreti i Presidentit nuk e ka shtensionuar situatën, përkundrazi, edhe veprimet e djeshme, të cilat i kemi dëgjuar në media, janë të papranueshme.

Tashmë të ndodhur në këtë situatë, a mendoni ju, zoti Balla, si nismëtar i kësaj nisme, se kjo nismë do të ndikojë në qetësimin e mëtejshëm të situatës, apo në ndezjen e saj?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Lita!

Urdhëroni, zoti Përmeti!

Të dëgjojmë edhe pyetjen e zotit Përmeti, më pas të përgjigjet për të gjitha pyetjet që i bëhen zotit Balla.

**Andi Përmeti** – Sot situata është relativisht shumë e vështirë dhe kam përshtypjen se dekreti i Presidentit e ka thelluar akoma më shumë konfliktin civil. Njerëzit me dekretin e Presidentit kanë shkuar KZA më KZA duke u vënë flakën dhe duke krijuar një konflikt. Ju, zoti Balla, dhe kur them ju e kam fjalën për Partinë Socialiste, meqenëse ju jeni sekretar i Përgjithshëm, a ndieni përgjegjësi për situatën ku jemi sot? A ndieni përgjegjësi që ju në rresht për pushtetin dhe karrigen tuaj votuat Ilir Metën, të gjithë bashkë, burra dhe gra këtu, pa kundërshtuar askush, duke e ditur shumë mirë që Ilir Meta nuk mund të ishte Presidenti i shqiptarëve? A e ndieni këtë përgjegjësi ju?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Balla, a mbani përgjegjësi ju, sepse e dinit shumë mirë që Ilir Meta, trashëgimlënësi i fronit mbretëror të LSI-së gruas së tij, ishte në fushatë si Presidenti i Shqipërisë dhe ju e votuat në rresht vetëm për të zgjatur karrigen tuaj? A keni ndonjë përgjegjësi ju sot për këtë?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Përmeti!

A ka pyetje të tjera nga kolegët, sepse nuk do të ketë më pyetje?

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

**Adriatik Alimadhi** – Më lejoni, zoti Balla, t'ju bëj një pyetje profesionale në lidhje me ecurinë dhe vazhdimin e procesit. Në fakt, ne nuk kemi Gjykatë Kushtetuese. Në qoftë se ju e keni marrë nismën për shkarkimin e Presidentit dhe ndodh kjo, a ia privojmë ne të drejtën Presidentit, sepse kemi një kapitull në Kushtetutë për ta ankimuar procesin ndaj tij?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Alimadhi!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Zoti Balla, ju lutem përgjigjuni pyetjeve të kolegëve.

**Taulant Balla** – Faleminderit, të nderuar kolegë të opozitës, zoti Gjoni, zoti Lita, zoti Përmeti dhe zoti Alimadhi, për pyetjet.

Po i mbledh ato si më poshtë.

Së pari, ajo që u prek sado pak në të katra ndërhyrjet: dua të theksoj që Presidenti i Republikës ka shkelur traditën kushtetuese të konsultimit të palëve. Nuk mund të ketë ndryshim të datës së zgjedhjeve pa pëlqimin paraprak të partive politike, që janë palë në procesin zgjedhor, aq më tepër kur procesi është gati në përfundim. Në rastin e ndryshimit të datës së zgjedhjeve të vitit 2007 dhe 2017 ishim tërësisht në një situatë krejt tjetër, së cilës iu referuat ju, zoti Gjoni, sepse palët u dakordësuan për shtyrjen e datës së zgjedhjeve dhe Presidentit të Republikës, zotit Bujar Nishani, iu vu në dispozicion edhe një dokument dakordësimi midis palëve. Në këto raste...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Gjoni!

**Taulant Balla** – Nuk është korrekte. Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Zoti Gjoni, ju lutem, mos e ndërprisni! Pastaj mund ta merrni fjalën.

**Taulant Balla** – Ju lutem, ta mbaroj! Me qetësi dhe dashuri, zoti Gjoni!

Në këto raste, Presidenti me konsensusin e tyre vendosi të shtynte datën në një datë tjetër, por pa cenuar ligjin dhe mandatin e organeve të zgjedhura. Shtyrja e datës u bë brenda kufijve të ligjit, pa cenuar atë që konsiderohet periudhë zgjedhore. Në rastin konkret çështja është krejt ndryshe, sepse data e zgjedhjeve shkon përtej datës 30 qershor, që është afati i fundit. Vetë dekreti, që Presidenti tentoi për të shfuqizuar, i është nënshtruar me rigorozitet kësaj procedure kushtetuese. Presidenti synon të zgjidhë një pseudokrizë institucionale, që e analizon në diskutimin e tij për të justifikuar anulimin e zgjedhjeve. Së pari, nëse ka krizë, kjo është një krizë dhe një luftë për mbijetesë e opozitës, e cila doli në rrugë dhe ka humbur besimin e elektoratit të saj dhe që braktisi institucionet demokratike, edhe këtu ku jemi, duke vepruar hapur dhe në kundërshtim me parimet demokratike. Kjo opozitë “rrugore” patjetër që po synon të destabilizojë vendin me protesta të dhunshme dhe me aktin e tij Presidenti mori kah të qartë drejt opozitës, duke shkelur betimin e tij si përfaqësues i unitetit kombëtar.

Së dyti, edhe nëse ka ndonjë problematikë institucionale, siç e theksoi me të drejtë zoti Lita, absolutisht nuk do të zgjidhej me një akt të pavlefshëm, që cenon të drejtat e shtetasve për të zgjedhur, siç është akti për shfuqizimin e dekretit të Presidentit, me të cilin cakton datën 30

qershor si datën e zgjedhjeve vendore, sepse nuk është i vetmi institucion që kujdeset për shtetin.

Për t'ju iluminuar, Presidenti deklaroi se zgjedhjet nuk mund të bëhen pa pjesëmarrjen në garë të aktorëve politikë. Pavarësisht se një pjesë e zotërinjve, që folën këtu janë aktorë politikë, të cilët do të marrin pjesë në zgjedhje, Presidenti bëri një analizë të përqindjes së votave të subjekteve politike, që kanë fituar në zgjedhjet e mëparshme, për të justifikuar që nuk mund të këtë zgjedhje nëse ata nuk regjistrohen si subjekte zgjedhore. Në këtë analizë teknike, pa dyshim, Presidenti mbajti anën e opozitës, veprimet e së cilës janë të qëllimshme dhe të papranueshme në demokraci. Presidenti nuk e përfaqëson më të gjithë popullin, duke shkelur parimin e unitetit kombëtar. Presidenti mori përsipër të japë leksione demokracie, të cilat nuk ekzistojnë në asnjë vend demokratik. Ju, zoti Gjoni, keni eksperiencë të vyer në këtë aspekt.

Zgjedhjet janë për popullin dhe jo për partitë. Një shtetas i përgjegjshëm, siç duhet të jetë, në fakt, Presidenti i Republikës duhet të shqetësohet që çdo shtetasi t'i krijohet mundësia reale të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën e tij kushtetuese të zgjedhjes dhe jo t'i mohohet ajo. Gjithashtu, ka rëndësi që shteti t'u krijojë kushtet optimale dhe të barabarta të gjitha partive dhe subjekteve politike për të garuar në zgjedhje, por zgjedhja e tyre për të mos u regjistruar në një garë elektorale, sikurse ka ndodhur me disa subjekte zgjedhore, nuk e cenon kursesi as në Shqipëri, as në ndonjë vend të BE-së dhe as në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, procesin zgjedhor. Për këtë gjë besoj se janë shumë të qarta, kuptimplota dhe shteruese të vendeve anëtare të BE-së dhe SHBA-ve. Ky i fundit, siç pranohet gjerësisht nga të gjithë partnerët, është i vlefshëm edhe pa pjesëmarrjen e partive të opozitës joparlamentare. Nëse partitë nuk marrin pjesë në zgjedhje, atëherë nuk kanë arsye pse të ekzistojnë, por kjo është puna e tyre.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Më falni, por zoti Përmeti më bëri një pyetje lidhur me përgjegjësinë që unë ndiej si sekretar i Përgjithshëm i Partisë Socialiste. Po partitë e tjera, që janë regjistruar? Unë citova këtu 38 parti që kanë votat e tyre në elektorat dhe nuk u cenohet e drejta kur Presidenti anulon zgjedhjet? Prandaj, ritheksoj dhe çmoj se ndërhyrja e Presidentit në këtë fazë të procesit zgjedhor ka cenuar rëndë barazinë e konkurrimit politik, duke shkelur kështu paanësinë politike.

Një pyetje tjetër kishte të bënte me precedentin e rrezikshëm.

Zonja dhe zotërinj,

Anëtarë të Komisionit të Ligjeve,



Presidenti me këtë veprim krijoi një precedent të rrezikshëm për republikën tonë parlamentare, ku ai në shumicën e rasteve ka thjesht dhe vetëm rol, të mos e mohojmë, protokollar. Me logjikën e Presidentit, i bie që ai mund të anulojë apo të shfuqizojë çdo dekret për emërime apo shkarkime. Imagjinoni sikur një ditë një autoritet, që emërohet apo çëmërohet me dekret të Presidentit, të çëmërohet apo riemërohet përsëri me dekret, sepse kështu i shkrepet në kokë Presidentit për ta vënë edhe një herë në detyrë. Kjo do të cenonte rëndë veprimtarinë shtetërore të tri pushteteve të shtetit, ku, siç e thamë më sipër, Presidenti merr pjesë, por më duhet ta them se ai nuk bën pjesë.

Mendoni një moment sikur KQZ-ja ta kishte pranuar për zbatim dekretin e datës 10 qershor. Çfarë do të ndodhte me pasojat, që kishte krijuar dekreti, që caktonte 30 qershorin si datën e zgjedhjeve? Janë kryer veprime administrative, janë harxhuar para nga buxheti i shtetit, janë marrë përsipër detyrime dhe përgjegjësi nga ai dekret, por kush do të mbajë përgjegjësi për pasojat, për shkeljen e të drejtave, për dëmet ekonomike, të cilat shkojnë në disa milionë dollarë; të mendosh pastaj pasojat juridike, siç ju thashë, mbi të cilat prevalon e drejta për t'u zgjedhur dhe e drejta për të zgjedhur, si parimi themelor i demokracisë, që kemi zgjedhur të gjithë për shtetin tonë shqiptar; të mendosh që pasojat shkojnë në kufi të abuzimit me pushtetin dhe me papërgjegjshmërinë e lartë të organit publik, që patjetër kanalizohet edhe te përgjegjësia penale?!

Faleminderit të gjithëve!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** - Ju lutem, zoti Gjoni, mbledhjen e drejtoj unë këtu!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Ju bëni pyetje dhe ai ju jep përgjigje, por nuk është e thënë që ti patjetër të marrësh atë përgjigje që do!

**Ralf Gjoni** – Të lutem, a mund ta përsëris edhe një herë pyetjen?

**Ulsi Manja** – E ka kuptuar pyetjen zoti Balla dhe jua dha edhe përgjigjen.

**Ralf Gjoni** – Të lutem, sepse është keqkuptuar lidhur me pyetjen.

Zoti Balla, unë nuk di që në Kushtetutë thuhet se Presidenti ka të drejtë të anulojë dhe të shfuqizojë dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve, me apo pa marrëveshje politike. Unë dua të di se ku e keni gjetur ju në Kushtetutë që Presidenti mund ta shtyjë datën e zgjedhjeve me marrëveshje politike!

Ju lutem, sepse, ndoshta, u keqkuptova, ndaj dua ta përsëris pyetjen time. Pse ju zgjodhët rrugën e propozimit për shkarkimin nga parlamenti të Presidentit, në mungesë të

Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që ekziston një Gjykatë Administrative dhe mund t'i drejtoheshit asaj? Kjo është një pyetje e sinqertë dhe unë dua një përgjigje të sinqertë, jo monologje politike.

**Taulant Balla** – Zoti Gjoni, përgjigja ime është në kërkesën e firmosur nga 55 firmëtarët. Nëse do ta lexoni me kujdes, aty do ta gjeni edhe përgjigjen.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Balla!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, zoti Alimadhi.

**Adriatik Alimadhi** - Të lutem, zoti kryetar, se nuk kemi marrë përgjigje!

**Ulsi Manja** – Unë jua kam bërë të qartë edhe herë të tjera: merreni fjalën, bëni pyetjet që keni për të bërë, katër, pesë, dhjetë apo sa të doni...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Ju jeni të zotët e pyetjes.

Zoti Balla, në emër të nismëtarëve, ka të drejtën e tij për të dhënë përgjigjet që duhet të japë.

Atëherë, një pyetje të fundit dhe më pas do të kalojmë në votim.

**Adriatik Alimadhi** – Pyetja është që ne kemi si Komisioni i Ligjeve...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Ulsi Manja** – Zoti Gjoni, ju lutem tani!

**Adriatik Alimadhi** – Zoti Balla, ju keni marrë një nismë për të shkarkuar Presidentin e Republikës, por, në fakt, të gjitha institucionet kushtetuese, që kanë lidhje zinxhir me njëri-tjetrin, nuk funksionojnë, ose nuk janë duke ushtruar kompetencat sipas ligjit. Ju tani doni të shkarkoni Presidentin dhe në momentin që ai shkarkohet, a ia privojmë në këtë rast të drejtën Presidentit për të bërë ankim në Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk funksionon?

**Ulsi Manja** – Kjo nuk ka lidhje.

Faleminderit, zoti Alimadhi!

Po, zoti Balla.

**Taulant Balla** – Zoti Alimadhi, ju e dini se procesi i shkarkimit përfundon në Gjykatën Kushtetuese, e cila është shkalla e fundit e këtij procesi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Shqipëria do të ketë së shpejti Gjykatën e saj Kushtetuese. Këtë gjë e konfirmoi dje edhe raportprogresi i KE-së. Ecuria e deritanishme e reformës në drejtësi është garanci për të pasur në Shqipëri institucione të vërteta të drejtësisë së pavarur.

Shumë faleminderit të gjithë anëtarëve të komisionit për vëmendjen dhe për bashkëpunimin gjatë kësaj seance parlamentare!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Balla!

Atëherë, sipas procedurës që ne miratuam në fillim të mbledhjes, duhet të caktojmë relatorët për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Unë propozoj që të kemi dy relatorë për t'i dhënë të gjithë rëndësinë dhe vëmendjen e duhur trajtimit të plotë nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore objektit të kësaj kërkesë. Unë propozoj që relatorët, që do të merren me shqyrtimin e kësaj kërkesë, të jenë kolegët: Adnor Shameti dhe Klotilda Bushka.

Kush është dakord që relatorët e kësaj kërkesë të jenë dy kolegët: Adnor Shameti dhe Klotilda Bushka? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Atëherë, relatorët që do të merren me shqyrtimin e kësaj kërkesë, nga ana e Komisionit të Ligjeve, do të jenë kolegët: Klotilda Bushka dhe Adnor Shameti.

Sipas kalendarit, dua t'ju bëj me dije se mbledhja e radhës do të zhvillohet ditën e hënë, në datën 24.06.2019, kurse ora do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit. Në rendin e ditës së hënë do të kemi vazhdimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës dhe do të jetë një seancë e gjerë diskutimi nga ana e kolegëve në Komisionin e Ligjeve.

Në zbatim të nenit 112/2 të Rregullores, rendi i ditës dhe ora e mbledhjes do t'i bëhen me dije Presidentit të Republikës, të cilit, nëse ka dëshirë që të dëgjohet në Komisionin e Ligjeve, do t'i krijojmë të gjithë mundësinë që të dëgjohet dhe të shprehet në lidhje me objektin e kërkesës së shkarkimit.

Këtu e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën sotme.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**

